



Breaking News:

- Drejtoria Vendore e Policisë Berat, gjatë 24 orëve të fundit
- Drejtoria Vendore e Policisë Fier, gjatë 24 orëve të fundit
- Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, gjatë 24 orëve të fundit
- Interpol Tirana – Ekstradohet nga Italia, 54-vjeçari i kërkuar për vrasje të trefishtë
- Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, gjatë 24 orëve të fundit



Lajmet

22/05/2024

Durrës – Falë Reagimit Në Kohë Dhe Veprimeve Profesionale Në Vendngjarje, Policia Zbarch Ngjarjen E Ndodhur Mbrëmë, Në Fshatin Shënavlash

Durrës

Falë reagimit në kohë dhe veprimeve profesionale në vendngjarje, Policia zbarch ngjarjen e ndodhur mbrëmë, në fshatin Shënavlash, ku u plagos me armë zjarri, në këmbë, 24-vjeçari E. B.

Si rezultat i veprimeve hetimore, identifikohet autori i dyshuar i plagosjes (kushëri i 24-vjeçarit).

Mbrëmjen e djeshme, pas marrjes së njoftimit se në Spitalin Rajonal Durrës ishte paraqitur për të marrë mjekim, shtetasi E. B., 24 vjeç, pasi ishte plagosur me armë zjarri, në këmbë, specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Durrës, në bashkëpunim me specialistët e Sektorit për Krimet e Rënda të DVP Durrës, shkuan menjëherë në vendin e ngjarjes, në oborrin e banesës së 24-vjeçarit, në fshatin Shënavlash, ku në drejtimin e prokurorit, kryen të gjitha veprimet hetimore për zbarchjen e rrethanave të rastit dhe identifikimin e autorit.

Nga veprimet e para hetimore rezultoi se autori i dyshuar është shtetasi I. B., 33 vjeç, banues në fshatin Shënavlash, i cili gjatë një konflikti të çastit, për motive të dobëta, ka plagosur me armë zjarri, në këmbë, djalin e xhaxhait të tij, shtetasin E. B., i cili vijon të jetë në spital, në kujdesin e mjekëve.

Vijon puna për kapjen e shtetasit I. B.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Reagim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit

Bulqizë – Vihet në pranga 1 shtetas, për veprën penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë” ▶